



**Ndërmarrja Publike Qendrore**  
**Posta e Kosovës Sh.A**

PK. SH.A.  
Posta e Kosovës SH.A.  
Post of Kosovo J.S.C.  
Pošta Kosova D.D.  
Nr./No./Br. 01-932/2025  
Data/Date/Datum 30-05-25  
PRISHINE-PRISTINA

Nr.26/25

Datë: 28/05/2025

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publik, si nenit 30 pika 1 dhe 12 të Statutit nr.01-2588/24 të datës 05.11.2024, Bordi i Drejtorëve i NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A. në mbledhjen e rregullt nr. 17/2024 të mbajtur më datë 25.10.2024, mori këtë:

## V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja nr.01-3060/24 të datës 31.12.2024 për Rregullimin e marrëdhënies së Punës si në vijim:
  - 1.1. Neni 6 paragrafi 2 i Rregullores bazike riformulohet si në vijim: Posta shpallë fillimisht konkurs të brendshëm për pozitën nga grada 6 deri në 13.
  - 1.2. Numri "15" tek pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 6 të Rregullores bazike fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me numrin "13".
  - 1.3. Pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 6 të Rregullores bazike riformulohet si në vijim: Posta shpallë menjëherë konkurs të jashtëm për pozitën me grada 3, 4 dhe 5, si dhe për pozitën me grada 14, 15, 16 dhe 17.
  - 1.4. Tek neni 13 i Rregullores bazike tek paragrafi 3, shtohet pika 3.1 si në vijim: "Procedura e vlerësimit të intervistës me gojë përmbanë gjithsej 100 pikë. Nëse kandidati/ja në intervistë me gojë nuk arrinë të marrë të paktën 55 pikë nga pikët totale, vlerësohet se nuk ka qenë i suksesshëm në intervistë"
2. Vendimi hynë në fuqi menjëherë.

## Arsyetim

Bordi i Drejtorëve sipas rregullit më datë 28.05.2025 ka mbajtur mbledhjen nr.07/2025, ku si pikë nr.9 "Të ndryshime" të agjendës ditore kishte pikën nën-pikën (c) "Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.01-3060/24 të datës 31.12.2024 për Rregullimin e marrëdhënies së Punës"

Drejtoria e Përkrahjes përmes e-mailit të datës 28.05.2024 i ka kërkuar Bordit të Drejtorëve që të bëjë plotësim ndryshimin e Rregullores nr.01-3060/24 të datës 31.12.2024 për Rregullimin e marrëdhënies së Punës, konkretisht ka kërkuar që për pozitën me gradë 14 ku bënë pjese Menaxheri i TI-së të shpallet konkurs i jashtëm në mungesë të resurseve të brendshme.

Bordi i Drejtorëve pasi vlerësoj këtë kërkesë theksoj që për të qenë në hap me kërkesat e tregut dhe për të siguruar një tranzicion të suksesshëm drejt modernizimit të shërbimeve postare, konsiderohet strategjike që pozita e Menaxherit të TI-së të rekrutohet përmes një konkursi të jashtëm, me qëllim të tërheqjes së kandidatëve me përvojë dhe njohuri të avancuara teknologjike dhe me këtë rast vendosi që të shkohet me konkurs të jashtëm nga grada 14 deri në gradën 17 pasi që këto pozita janë kryciale për ndërmarrjen dhe janë bartëse të proceseve dhe zhvillimit të saj, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Gëzim Paci



I dërgohet:

- 1x Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve;
- 1x Kryeshefit Ekzekutiv të PK-së;
- 1x KP/SK të PK-së;
- 1x Aksionarit – NJPMNP;
- 1x Drejtorisë së Përkrahjes;
- 1x Arkivës të PK-së.



Ndërmarrja Publike Qendrore  
Posta e Kosovës Sh.A

PK. SH.A.  
Posta e Kosovës SH.A.  
Post of Kosovo J.S.C.  
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-932/2025  
Data/Date/Datum 30-05-25  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Datë: 28/05/2025

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publik, si nenit 30 pika 1 dhe 12 të Statutit nr.01-2588/24 të datës 05.11.2024, Bordi i Drejtorëve i NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A. në mbledhjen e rregullt nr. 17/2024 të mbajtur më datë 25.10.2024, sipas vendimit nr.26/25 miratoj këtë:

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 01-3060/24 TË DATËS 31.12.2024 PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR PUNONJËSIT E POSTËS KOSOVËS**

**Neni 1**

1. Neni 6 paragrafi 2 i Rregullores bazike riformulohet si në vijim: Posta shpallë fillimisht konkurs të brendshëm për pozitat nga grada 6 deri në 13.
2. Numri "15" tek pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 6 të Rregullores bazike fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me numrin "13".
3. Pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 6 të Rregullores bazike riformulohet si në vijim: Posta shpallë menjëherë konkurs të jashtëm për pozitat me grada 3, 4 dhe 5, si dhe për pozitat me grada 14, 15,16 dhe 17.

**Neni 2**

2. Tek neni 13 i Rregullores bazike tek paragrafi 3, shtohet pika 3.1 si në vijim: "Procedura e vlerësimit të intervistës me gojë përmbanë gjithsej 100 pikë. Nëse kandidati/ja në intervistë me gojë nuk arrinë të marrë të paktën 55 pikë nga pikët totale, vlerësohet se nuk ka qenë i suksesshëm në intervistë"

**Neni 3**

Kjo rregullore hynë në fuqi nga data 30.05.2025

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Gëzim Paci

